

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.8

Shtator 2021



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NIS BASHKËPUNIMIN ME INSPEKTORATIN E BULLGARISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti në një vizitë pune znj. Toedora Tochkova, Inspektor i Lartë i Inspektoriatit të Këshillit të Lartë Gjyqësor i Republikës së Bullgarisë dhe delegacionin që e shoqëron.

Gjatë takimit të dy Inspektorët e Lartë konfirmuan vullnetin për të bashkëpunimin dypalësh, në praktikave për hetimin e disiplinore dhe inspektimeve dhe në çështjet e interesit të përbashkët.

Z. Metani dhe znj. Tochkova evidentuan se nisur nga funksioni i institucioneve që drejtojnë, ekziston një interes i përbashkët, për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, të pavarësisë së sistemit të drejtësisë, garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si dhe mbrojtjen e interesit publik.



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Bashkëpunim midis Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektoratit të Bullgarisë

Kjo vizitë pune shënon fillimin e një bashkëpunimi konkret mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoriatit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë dhe është në vijim të kontakteve, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po vendos me homologë të vendeve të Europës për shkëmbimin e praktikave më të mira të punës.



Ankimimi në ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion.

Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al
- ⇒ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- ⇒ Mund të plotësohet pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.



“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

STATISTIKA

Gjatë muajit **Shtator**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **70 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

Konkretisht:

65 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

5 ankesa kanë ardhur nga institucionet;

37 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

29 takime me ankues.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Shtator 2021.



Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI MES INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË DHE INSPEKTORATIT TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR TË BULLGARISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë së Shqipërisë dhe Inspektoriati i Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë e formalizuan bashkëpunimin mes tyre përmes nënshkrimit të një memorandumi të përbashkët mirëkuptimi.

Në memorandumin, që u nënshkrua në ambientet e ILD-së, mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani dhe Inspektorit të Lartë Teodora Tochkova, parashikohet shkëmbimi i praktikave dhe përvojave më të mira, në kuadër të procedurave të verifikimit të ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore, fillimit të procedurës disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe të realizimit të inspektimeve institucionale e tematike.

Shkëmbimi i informacioneve mbi sistemin ligjor dhe legjislacionin në fushën e procedurave disiplinore ndaj magjistratëve, masat e zbatimit të ligjit në fushat e juridiksionit të tyre dhe eksperiencën e tyre ndërkombëtare, të zbatueshme gjatë procedurës së hetimit disiplinor, përfshirë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është një dimension tjetër i memorandumit të mirëkuptimit së bashku me shkëmbimin e përvojës mbi mënyrën e komunikimit me publikun me qëllim garantimin e parimit të transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale e integritetit të magjistratëve.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË INKURAJIM PËR STUDENTËT AMBICIOZË TË JURISPRUDENCËS

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e ka pjesë të vizionit të vet mikpritjen për praktikë profesionale të studentëve ambiciozë, që dëshirojnë të thellojnë njohuritë e tyre, duke parë nga afër mënyrën sesi funksionon ILD.

Në muajin Shtator, ekipit të ILD-së iu bashkua për një praktikë pune studenti nga Gjermania, Maxim Kasolowsky, që ka zgjedhur të studiojë për drejtësi pranë Universitetit të Oksfordit.

Z.Kasolowsky u fokusua tek praktika e tij pranë ILD-së tek hetimi disiplinor ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, një praktikë e cila në Shqipëri tashmë kryhet nga një institucion i vetëm, sic është Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe krahasimi me praktikat europiane.


Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani dhe anëtarë të kabinetit ndoqën prezantimin e z. Kasolowski mbi praktikat më të mira të institucioneve homologe të inspektimit në Europë, një dokumentim i punës kërkimore të tij pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



Shtator 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani](#)
[@ILD_Albania](#)



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë](#)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)